

MARENGLLEN VERLI**REDUKTIMI DRASTIK I POPULLSISË SHQIPTARE NË
KOSOVË DHE NË VISET E TJERA GJATË VITEVE 1912-1921***

Tema e kësaj kumtese është një temë tepër e njohur nga shumë studiues profesionistë e amatorë. Ata i janë qasur problemit të reduktimeve anormale demografike të popullsisë shqiptare të Kosovës e më gjerë, duke u përpjekur të saktësojnë për periudha të ndryshme kohore, në nivel të përgjithshëm ose lokal, çfarë ka ndodhur, kur dhe ku ka ndodhur, e përse ka ndodhur. Zakonisht ndryshimet e dukshme numerike të popullsisë rrjedhin prej faktorëve të jashtëzakonshëm politikë e ushtarakë, praktikave gjenocidale, prej kolapseve ekonomike, katastrofave natyrore, pandemive etj. Disa nga këta faktorë kanë qenë të pranishëm në Kosovë e më gjerë edhe në periudhën 1912-1921, që është objekt trajtimi në këtë kumtesë.

Studiues të statistikave, vëzhgues të terrenit e shtetarë prestigjiozë, autorë të publikimeve të shumta të shek. XIX dhe dekadave të para të shek. XX, austriakë, francezë, italianë, britanikë, turq, serbë, bullgarë etj., që nga M. A. Ubiçini (Ubicini), E. Bore, F. Lipih (Lipich), T. Ipen (Ippen), E. Vit (Wiet), F. Akbal, A. Stranieri, J. G. Hahni (Hahn), A. Bue (Boue), G. Lezhan (Lejean), G. Dypon (Dypont), F. Bradashka, F. Biankoni, H. Hekard (Hecquard), E. Stanford, Xh. Bejker (Baker), S. Gopçeviq (Gopčević), V. Berar (Berard), V. Krençov (Krnčov), A. Baldaci, P. Orloviq (Orlović), J. Cvijiq (Cvijić), N. Jorga, J. Haxhivasiljeviq (Hadzivasiljević) e deri tek autorët bashkëkohorë N. Todorov, K. H. Karpal, P. Bartl, S. Karastojanov, H. Doğru, N. Akbajar etj., si dhe një varg studiuesish shqiptarë, si: S. Frashëri, M. Frashëri, S. Rizaj, S. Pulaha, K. Frashëri, K. Prifti, H. Bajrami, J. Drançolli, F. Duka, E. Pllana, H. Kaleshi, Z. Shkodra, R. Abdylly, H. Islami, J. Osmani etj.¹

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”, organizuar në Prishtinë, më 7-8 prill 2022 nga Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Instituti i Historisë (ASA) Tiranë dhe Instituti Albanologjik Prishtinë.

¹ Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovës 1831-1912*, Akademia e Shkencave, Tiranë: 2014, f. 25-55, fletet gjerësisht për botimet dhe kontributet e autorëve të sipërpërmendur.

(të më falin të gjithë ata autorë që për mungesë kohe nuk po i përmend dot këtu), na kanë shtruar rrugën, duke na dhënë argumentet e tyre, qoftë për numrin e përgjithshëm të shqiptarëve në vitin 1912, qoftë për numrin e të masakruarve e të shpërngulurve gjatë e pas Luftërave Ballkanike, në vitet 1912-1914, por edhe më pas, deri në vitin 1921. Duke operuar veçanërisht me të dhënat e regjistrit osman të viteve 1905-1907 (filloi më 1903)², por edhe të dhëna të tjera të 64 salnameve të botuara në vitet 1846-1908, si edhe të dhënave të tjera të burimeve të ndryshme, deri në vitin 1912, autorët e sipërpërmendur e vlerësojnë popullsinë shqiptare që jetonte kryesisht në trojet e veta në Ballkanin Perëndimor midis 1,5 milionë (K. Frashëri) deri në 2 milionë frymë (K. Prifti, A. Baldaçi).³

Profesor Kristaq Prifti vlerëson se në një territor prej rreth 75-76 mijë km² të trojeve shqiptare, d.m.th. të viseve të banuara në shumicë nga shqiptarët, por edhe në vise të tjera periferike më tej, në vitin 1912 jetonin rreth 2 milionë shqiptarë. Në trevat shqiptare ndërkohë kishte edhe rreth 200 mijë pjesëtarë të pakicave kombëtare, kryesisht serbë, bullgaro-maqedonas dhe grekë. Me ndarjen e kufijve më 1913, në Shqipërinë politike u përfshinë 28 565 km², ose 36% e viseve shqiptare dhe një popullsi prej 737 mijë banorësh, nga të cilët rreth 700 mijë shqiptarë dhe 37 mijë pjesëtarë të pakicave kombëtare, nga të cilët 2/3 ishin grekë.⁴

Sipas të dhënave të kohës, në fund të shek. XIX, Bullgaria kishte 96 000 km² dhe 3,3 milionë banorë; Serbia 48 000 km² dhe 2,37 milionë banorë; Greqia 64 600 km² dhe 2,6 milionë banorë (së paku 1/3 arvanitë); Mali i Zi 9 000 km² dhe 250 mijë banorë.⁵

Me një llogaritje të thjeshtë rezulton se në rreth 47 000 - 48 000 km² të viseve të copëtuara shqiptare, përkatësisht në 64% të gjithë viseve shqiptare, të cilat u aneksuan nga fqinjët, mbeten së paku 1,2 milionë shqiptarë dhe prej tyre, rreth 1,1 milionë iu “dhuruan” nga Fuqitë e

² Po aty, f. 21, 23, 40. Gjatë shek. XIX regjistrimet u kryen më 1831 dhe 1881/82-1890.

³ Krahaso: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 30; K. Prifti, *Popullsia e Kosovës...*, f. 1030; Antonio Baldacci, *L'Albania*, Istituto per l'Europa Orientale, Roma: 1929, f. 199-201; *Vjetari statistikor i vitit 1980*, botim i Komisionit të Planit të Shtetit, Drejtorja e Statistikës, Tiranë: 1980, f. 23.

⁴ Po aty.

⁵ Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 8 Nëntori, 1984, f. 32; Jacob Gould Schurman, *Luftërat Ballkanike (1912-1913)*, Tiranë: Uegen, 2006, f. 46.

Mëdha, Serbisë dhe Malit të Zi.⁶ Rreth 700-750 mijë frymë kishin qenë më parë banorë të vilajetit të Kosovës, që përfshinte para vitit 1912 edhe sanxhakun e Shkupit, kazanë e Tetovës dhe nahijen e Gostivarit, i cili kishte pasur një sipërfaqe prej 32 900 km² dhe 1 314 499 banorë. Rreth 300 mijë shqiptarë, kishin qenë banorë të ish vilajetit të Manastirit, kurse pjesa tjetër ishin banorë të viseve veriore e veriperëndimore shqiptare.⁷

Dhjetë vjet më vonë, në regjistrimin e kryer nga Mbretëria Serbo-Kroate-Sllovene në vitin 1921 (mbi bazën e përkatësisë fetare dhe të gjuhës së folur), shqiptarët në këtë shtet figurojnë, të shënuar sipas gjuhës, rreth 400 mijë deri në 500 mijë, kurse popullsia myslimane, në përgjithësi, në trevat shqiptare shënohet pak më tepër se 566 mijë.⁸ Në Kosovë, në kufijtë e sotëm (10 908 km²), në vitin 1921 figuronin gjithsej 439 mijë banorë, nga të cilët rreth 359 shqiptarë.⁹ Çfarë kishte ndodhur që me gjithë shtesën 10-vjeçare, 1912-1921, e cila në vite normale gjatë disa dekadave kishte qenë rreth 10%, popullsia ishte pakësuar nga 1,2-1,3 milionë, sa do të duhej normalisht të ishte, duke llogaritur natalitetin dhe mortalitetin në rrethana normale, në rreth gjysmë milioni, pra ishte reduktuar mbi 60%. Është për të theksuar se edhe në regjistrimin e vitit 1948, shqiptarët në Kosovë ishin më pak se 500 mijë (498 244 banorë), kurse në gjithë Jugosllavinë vetëm 733 034 banorë nga rreth 1,1 milionë që kishin qenë në vitin 1912.¹⁰ Në kushte normale shqiptarët në

⁶ Lumo Skëndo, "Popullsia shqiptare më 1921, jashtë Shqipërisë", në *Kalendari Kombiar*, Tiranë, 1926, f. 35 etj.; shih edhe Hivzi Islami, *Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës*, Prishtinë: 2005, f. 414. Sipas të dhënave të tyre para Luftës së Parë Botërore, në Greqi jetonin 115 mijë shqiptarë në rrethet e Kosturit e Follorinës, në Janinë e Çamëri.

⁷ K. Prifti, *Popullsia e Kosovës...*, f. 1030; Lumo Skëndo, *Albanais et Slaves*, Lausanne: Librairie Centrale des Nationalités, 1919, f. 6.

⁸ Hivzi Islami, *Studime demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë: 2005, f. 243, 247, 250; J. McCarthy, *Historia e popullsisë së Lindjes së Mesme dhe Ballkanit*, Tiranë, ALSAR, 2017, f. 49; *Vjetari Statistikor i KSA Kosovës*, 1989, Prishtinë: 1989, f. 28, 30.

⁹ Po aty.

¹⁰ *Vjetari statistikor i KSA të Kosovës ...*, 1989, f. 28, 30. Në vitin 1921, Kosova në kufijtë e sotëm të Republikës së Kosovës, me 10 908 km² kishte 439 010 banorë, nga të cilët rreth 350 000 shqiptarë, kurse më 1931 kishte 552 064 banorë, nga të cilët rreth 400 mijë shqiptarë. Sipas H. Islamit, *Studime demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës ...*, f. 243, 247, 250, në vitin 1948, në Kosovë jetonin 498 244 shqiptarë, në Republikën e Maqedonisë jetonin 197 389 shqiptarë (17,1% e popullsisë së kësaj republike), në Republikën e Serbisë jetonin 33 289 shqiptarë (0,8% e

Jugosllavi në vitin 1948 do të duhej të ishin rreth 1,5 milionë banorë, duke llogaritur shtesën, përafërsisht me parametrat e shtesës së popullsisë në shtetin shqiptar. Popullsia në Shqipëri në periudhën në fjalë, 1912-1945 ishte shtuar nga 737 mijë banorë në 1 122 000 banorë, pra me 35%.¹¹

Përgjigjja për situatën demografike të sipërpërmendur dihet. Periudha e viteve 1912-1921 u karakterizua nga luftëra të njëpasnjëshme, sikurse ishin dy Luftërat Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore, nga një pandemi katastrofike e “gripit spanjoll” në vitet 1917-1918, por dhe nga politika e institucionalizuar e spastrimit etnik, që Serbia e Mali i Zi zbatuan ndaj shqiptarëve në shumë forma, ku spikasnin masakrat e pashembullta të ushtrisë e çetnikëve serbë e malazezë, të viteve 1912-1913.¹²

Statistikat e siguruara dhe të publikuara nga shërbimet diplomatike dhe të inteligjencës së Fuqive të Mëdha, të hartuara mbi bazën e vrojtimeve serioze në terren, si ato të bëra nga fondacioni Carnegie Commission of Investigation (1914), botime të dokumentuara si “Golgota Shqiptare” e Leo Frenndlich (1913), njoftime denoncuese të gazetës socialdemokrate “Radničke Novine” (1913), apo të personaliteteve të njohura si Dimitrije Tucovic, Leon Trocki, Edith Durham etj., bëjnë fjalë për disa dhjetëra mijë të vranë.¹³ Vrasje të konsiderueshme pati dhe në vitet 1919-1921¹⁴, por humbjet nga këto vrasje ishin vetëm një pjesë relativisht e vogël e humbjeve, që sollën reduktim të dukshëm të numrit

popullsisë) dhe në Malin e Zi 19 425 banorë (5,2% e popullsisë). Në gjithë Jugosllavinë më 1948 jetonin 748 347 shqiptarë.

¹¹ *Vjetari Statistikor i vitit 1980*, botim i Komisionit të Planit të Shtetit, Drejtoria e Statistikës, Tiranë: 1980, f. 23.

¹² Marenglen Verli, *Shqiptarët përballë sfidave të historisë*, vëll. I, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë: 2021, f. 55, 316, 325, 359 etj.

¹³ *Dotation Carnegie pour la paix internationale. Enquête dans les Balkans. Rapport présenté aux directeurs de la dotation par les membres de la commission d'enquête*, Paris: Centre Europeen de la Dotation Carnegie, 1914; Leo Frenndlicht, *Albanians Golgotha*, Anklageahten gegen die vernichter des Alban orvolkes, Vienna: 1913; *Radničke Novine*, Beograd: 1913; Edith Durham, *Albania and the Albanians: Selected Articles and Letters (1903-1944)*, London: J. B. Tauris, 2001; Dhimitër Tucoviç, *Serbia dhe Shqipëria. Një shtesë kritikës së politikës pushtuese të borgjezisë serbe*, Prishtinë: 1968.

¹⁴ Hakif Bajrami, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë, më 1918-1941*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 1981; Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918-1928)*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 1981.

të popullsisë. Nuk disponohen të dhëna të sigurta për vdekjet e shkaktuara nga gripi spanjoll në Kosovë e në viset e tjera shqiptare Lindore e Veriperëndimore (në Shqipëri ato llogariten në rreth 5% të popullsisë), por gjithsesi, goditjen dërrmuese, që përgjysmoi popullsinë shqiptare e dha shpërngulja e një përmase biblike, e shkaktuar pa dyshim, fillimisht nga dhuna e terrori, dhe më pas nga politika e shpronësimit dhe e kolonizimit, nga politika tatimore, politika e bllokimit ekonomik, e injorimit social dhe trysnisë në sferat kulturore, arsimore, fetare etj.¹⁵

Shpërngulja masive e shqiptarëve ishte paraparë jo vetëm në programet shtetërore të Serbisë e Malit të Zi, por edhe në Marrëveshjen Serbo-Osmane të Paqes të vitit 1913. Në nenin 4 të saj përcaktohej që popullsia e besimit mysliman të kishte të drejtë të plotë të shpërngulej brenda tre vjetëve, deri më 1915, duke u liruar nga të gjitha detyrimet ligjore nga shteti serb.¹⁶

Studiuesi Z. Shtylla, që është marrë posaçërisht me çështjen e shpërnguljeve të shqiptarëve nga Jugosllavia në vitet 1912-1941, e vlerëson numrin e të shpërngulurve gjatë këtyre 29 vjetëve në rreth 300 000 vetë.¹⁷

Sipas të dhënave të konsullatës serbe në Selanik, nga nëntori i 1912 deri në korrik 1914, nga Kosova, Sanxhaku e Maqedonia, u shpërngulën përmes Selanikut drejt Turqisë 255 878 myslimanë, nga të cilët 215 412 shqiptarë.¹⁸ Të dhëna të tjera bëjnë fjalë për rreth 343 000 të shpërngulur përmes portit të Selanikut, për të cilët pretendohet se u përdorën 335 anije. Rreth 40 mijë të tjerë u shpërngulën përmes linjës hekurudhore, kurse dhjetëra mijë të tjerë udhëtonin me karvanë e me mjete personale ose më këmbë, në një udhëtim krejt të pasigurt.¹⁹ Ndërkohë,

¹⁵ Po aty; Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë (1918-1941)*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë: Iliria, 1992.

¹⁶ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 427-428; shih dhe *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, botim i Akademisë së Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, vëll. I, Tiranë: Kristalina-KH, 2017, f. 459-460.

¹⁷ Zamir Shtylla, “Shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve në vitet 1912-1941”, në vëllimin *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, botim i ASH, Tiranë: 1990, f. 260, 273.

¹⁸ Hakif Bajrami, *Kosova. Rrethanat shoqërore e politike në Kosovë më 1918-1941*, Prishtinë: 2017, f. 177; H. Islami, *Studime demografike...*, f. 287; *Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995)*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë: 1997, f. 42.

¹⁹ Hakif Bajrami, *Si e okupoj Serbia Kosovën më 1912*, Prishtinë: 2003, f. 204.

dokumentacioni i Serbisë përmban të dhëna që vlerësojnë se nga nëntori 1912 deri në korrik 1914, numri i të shpërngulurve drejt Anadollit kishte arritur në rreth 412 000 vetë.²⁰ Kurse, sipas Komitetit “MKK”, me seli në Shkodër, të krijuar më 1918, në vitet 1912-1915, përmasat e eksodit ishin të tilla që kapën shifrën deri 500 000 shqiptarë.²¹

Krahasimi i të dhënave nga vitet para Luftërave Ballkanike me ato të regjistrimit të vitit 1921, çon në përfundimin se popullsia shqiptare në viset që iu dhanë më 1913 Serbisë dhe Malit të Zi, ishte reduktuar gjatë periudhës 1912-1921 në masën 50-60%, dhe rreth $\frac{3}{4}$ e tyre i përkisnin periudhës 1912-1915. Politika e pushtuesve për spastrimin etnik të viseve shqiptare kishte qenë katastrofike.²² Shqiptarët kishin paguar, siç del nga të dhënat krahasuese, shumë shtrenjtë, madje më shtrenjtë se myslimanët e tjerë të Ballkanit, ndonëse kishin dhënë një kontribut të madh për rënien e fuqisë osmane me kryengritje të fuqishme gjatë disa vjetëve, dhe kështu kishin kontribuar në përfundimin e sundimit osman në Ballkan.

Sipas studiesit amerikan Justin Mearth, popullsia e besimit mysliman e kombësive të ndryshme në viset e Ballkanit, të pushtuara e të aneksuara nga shtetet e Aleancës Ballkanike, vetëm në vitet 1912-1913, u reduktua për rreth 40%. Gjysma e tyre humbi jetën në mënyra të ndryshme dhe nuk mbërriti në territorin që i mbeti Perandorisë Osmane, të cilin e kishte si destinacion.²³ Po ky autor pohon se nga 1 241 076 myslimanë që jetonin në vitin 1911, në viset që më pas, në vitin 1913, me vendimet e Konferencës së Londrës, u përfshinë në Serbi e Malin e Zi, më 1921 kishin mbetur vetëm 566 478. Humbja ishte në masën 55%.²⁴

Kështu, mund të përfundojmë, se shifra prej rreth 240-300 mijë të shpërngulurish, për viset që pushtuan dhe aneksuan Serbia dhe Mali i Zi, më pas Mbretëria SKS, e dhënë rëndom deri më sot për periudhën 1912-1921 nga shumë studiues (duke pasur parasysh me sa duket muhaxhirët që arritën të strehoheshin brenda territorit që i mbeti Perandorisë Osmane nga viti 1913, dhe që u regjistruan nga nëpunësit e “Muharxhihanes”, e

²⁰ *Dokumenti o spolnoj politici Kraljevine Srbije*, Knjiga VII, SANU Bgd Odelenje Istorijskih Nauka, Beograd: 1980, f. 617-618.

²¹ Hakif Bajrami, *Kosova – Njëzet shekuj të identitetit të saj*, Prishtinë: Era, 2001, f. 78.

²² K. Prifti, *Popullsia e Kosovës ...*, f. 1030-1031; Justin McCarthy, *Vdekje dhe dëbim, spastrimi etnik i myslimanëve osmanë (1821-1922)*, Tiranë: ALSAR, 2015, f. 386-390.

²³ J. McCarthy, *Popujt Osmanë dhe fundi i Perandorisë*, Tiranë: ALSAR, 2017, f. 111.

²⁴ J. McCarthy, *Historia e popullsisë së Lindjes së Mesme dhe Ballkanit...*, f. 128.

cila trajtonte problemet e të ardhurve), ka qenë një shifër joreale. Ata që u larguan veçanërisht gjatë kohës së Luftërave Ballkanike, kishte qenë e pamundur të evidentoheshin, dhe nga ata që morën rrugët për t'i shpëtuar terrorit, rezulton se vetëm gjysma mbërritën në destinacion. Duke pasur në duar edhe të dhëna për viset e tjera të Ballkanit, ne më në fund, përmes krahasimit dhe analizës, mund të themi se i jemi qasur së vërtetës për eksodin e pashembullt i cili tronditi rrënjët e kombit autokton shqiptar, por që për fat dhe falë qëndresës së jashtëzakonshme shumëformëshe, nuk arriti ta asgjësojë. Kombi shqiptar diti t'i rikuperojë humbjet dhe të riformatojë pozicionin e vet në Ballkan si faktor i rëndësishëm, sikurse kishte qenë gjithmonë edhe në të kaluarën.

